NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE
NPL "KU'ZINA" SH.A.
PRISHTINË
Nr. 0779 Dt. 13.10.2026

Prishtinë, 13.10.2027

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Statutit të NPL "Ku'zina" Sh.A., Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe akteve të tjera të zbatueshme, NPL "Ku'zina" Sh.A. shpall:

KONKURS PUBLIK

Pozita: ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR DHE I THESARIT
Numri i pozitave: 1 (një)
Vendi i punës: Prishtinë
Punëdhënësi: NPL "Ku'zina" Sh.A.
Raporton te: Bordi i drejtorëve dhe organet kompetente të ndërmarrjes, sipas Statutit dhe legjislacionit në fuqi.
Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: 3 vite.
Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë.
Paga: Sipas politikave të pagave dhe akteve të brendshme të ndërmarrjes.

I. QËLLIMI I POZITËS

Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit është përgjegjës për drejtimin, organizimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e përgjithshëm të funksioneve financiare dhe të thesarit të ndërmarrjes.
Qëllimi kryesor i pozitës është sigurimi i menaxhimit efikas, transparent dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare, ruajtja e likuiditetit, planifikimi dhe kontrolli buxhetor, raportimi i saktë financiar dhe garantimi i përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet e zbatueshme.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Menaxhon, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv çështjet financiare të ndërmarrjes.
- Në aspektin financiar është bashkëpunëtori më i afërt i KE-së
- Bashkërendon veprimtarin e departamentit të financave.
- Është përgjegjësi kryesor për përgatitjen e planeve dhe raporteve financiare;
- Merr pjesë në takimet e Bordit dhe të Komisionit të Auditimit, sipas kërkesës.
- Përgatitë buxhetin dhe kryen detyra tjera nga fusha e financave të përcaktuara nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.

III. KUALIFIKIMET DHE KRITERET E KËRKUARA

Kriteret e përgjithshme

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të plotësojë kushtet ligjore për punësim dhe ushtrimin e funksionit.
- Të ketë integritet profesional dhe etik.

- Të mos ketë pengesa ligjore për ushtrimin e pozitës.

Kualifikimi arsimor

- Diplomë universitare në ekonomi, financa, kontabilitet, bankë ose fusha të tjera të përafërta ekonomike, me së paku 240 ECTS ose ekuivalente, në përputhje me kërkesat ligjore të zbatueshme.
- Studimet pasuniversitare në financa, kontabilitet, menaxhim financiar ose fusha të ngjashme përbëjnë përparësi.

Përvoja profesionale

- Së paku 5 (pesë) vite përvojë profesionale relevante në financa, kontabilitet, buxhetim, thesar ose auditim financiar.
- Përvoja në pozita udhëheqëse ose menaxheriale financiare përbën përparësi.
- Përvoja në ndërmarrje publike, shoqëri aksionare ose organizata me operacione të konsiderueshme financiare përbën përparësi.

Njohuritë dhe aftësitë profesionale

- Njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të të Kontabilistëve (FNK) do të jenë përparësi;
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të cilave raporton Ndërmarrja.
- Aftësi për udhëheqjen e ekipeve dhe bashkëpunim ndërinstitucional.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe raportimi profesional.
- Njohja e gjuhës angleze përbën përparësi.

Certifikimet profesionale

Të jetë Kontabilist i certifikuar sipas një programi në përputhje me standardet Ndërkombëtare të Edukimit(SNE) dhe sipas udhëzimeve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), kualifikimi si kontabilist i certifikuar konsiderohet përparësi;

IV. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Aplikacionin (merret në zyrën e ndërmarrjes ose në ueb faqe të ndërmarrjes, www.kuzhina.net)
- CV-në
- Letër motivimin
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional të noterizuar (Diplomat/Certifikatat dhe dokumente të ngjashme të marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara).

- Dëshmitë mbi përvojën e punës e vërtetuar me trustin pensional (Aplikacioni duhet të ofroj të dhëna të sakta mbi periudhat e angazhimit dhe të korrespondojë me dokumentet vërtetuese).
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo me e vjetër se gjashtë muaj)
- Deklaratën nën betim (merret në zyrat e ndërmarrjes, ose në ëeb faqe te ndërmarrjes).
    - Me këtë dokument kandidati deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të nenit 17 të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087. Çdo përgënjeshtrim material - qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca - ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.
- Kopjen e letërnjoftimit
- Lista kontrolluese (merret në zyrën e ndërmarrjes).

V. INFORMATA PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT.

Konkursi do të jetë i hapur nga data **13.10.2026** deri më datën **27.10.2026.** Dokumentacioni i aplikantëve mund të dorëzohet në arkivin e N.P.L. KU'ZINA SH.A. në Prishtinë, çdo dite pune prej orës 8:00 - 16:00, ose nëpërmes postes fizike; (në zarf të mbyllur) të adresuar: Për Bordin e Drejtoreve të **N.P.L. KU'ZINA SH.A. Rr. Musa Tolaj p.n. - 10 000** në Prishtinë - "Aplikacion për ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR DHE I THESARIT ".

Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje të noterizuara, ndërsa origjinali i tyre, do të kërkohet në fazat e më vonshme të përzgjedhjes. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail adresës: **kuzhinaqendrore@gmail.com.** ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ndërmarrjes. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Të gjithë formularët duhet plotësuar në tërësi, mos plotësimi i tyre dhe informatat e pasakta do të rezultojnë ne diskualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Bordi i drejtorëve do të zhvilloj një procedurë të hapur /transparente dhe konkurruese, ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform Ligjit në fuqi dhe pa asnjë lloj diskriminimi, për çka inkurajon në aplikim kandidatët:

- nga gjinia femërore,
- kandidatët nga të gjitha komunitetet e Republikës se Kosovës; si dhe
- kandidatët nga të gjitha kategoritë tjera me pak të përfaqësuara në institucionet/organet/organizatat e vendit.

Ndërmarrja mund të kërkojë dokumentacion plotësues dhe verifikim të dokumenteve për kandidatët e përzgjedhur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Afati i fundit për aplikim: 27.10.2026

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar ose që nuk përmbajnë dokumentacionin e detyrueshëm mund të refuzohen sipas kushteve të konkursit.

VI. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e kandidatëve realizohet përmes procedurës konkurruese, transparente dhe të bazuar në meritë, në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.
Procedura mund të përfshijë:

- Verifikimin administrativ të dokumentacionit dhe plotësimit të kritereve.
- Vlerësimin e kualifikimeve dhe përvojës profesionale.
- Intervistën profesionale dhe menaxheriale.
- Verifikimin përfundimtar të dokumentacionit dhe kushteve ligjore.

Kandidatët do të vlerësohen në bazë të kritereve objektive dhe metodologjisë së miratuar nga organi kompetent.

VII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NPL "Ku'zina" Sh.A. garanton mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët dhe zbaton parimet e mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit dhe përzgjedhjes në bazë të meritës.
Kandidatët janë përgjegjës për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur.

NPL "KU'ZINA" SH.A.
Prishtinë, Republika e Kosovës

NPL KU'ZINA SH.A. PRISHTINË
NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE - LOCAL PUBLIC ENTERPRISE